



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Prade - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Kancelarija Ministra Pravde - Cabinet of the Minister of Justice

Nr. 433 /2024

Datë: 16/12 /2024

Në mbështetje të nenit 9, 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (GZ/Nr. 7/01 mars 2019, Prishtinë), në bazë të nenit 11 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 08/L-175 për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, si dhe në përputhje me nenin 6 (paragrafi 1, 2 dhe 6) të Rregullores QRK-nr. 15/2024 për klasifikimin, ndryshimin e statusit të klasifikimit, asgjësimin dhe shkatërrimin e informacionit të klasifikuar, Ministria e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

- Emërohet Komisioni për përpilimin e listës së informacionit të klasifikuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, në këtë përbërje:
 - Ridvan Hoti- Ud. Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm për trajtim;
 - Besar Gashi- Ud. Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm për siguri dhe operative;
 - Agim Demiri- Drejtor i Departamentit ligjor;
 - Ardita Blakaj- Ud. Drejtor i Qendrës Korrektuese në Lipjan;
 - Xhevdet Maqastena- Drejtor i Burgut të Sigurisë së lartë.
- Obligohet Komisioni sipas pikës (1) të këtij vendimi që detyrat dhe përgjegjësitë e tij të kryej në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.
- Komisioni i themeluar sipas pikës (1) të këtij vendimi, është i obliguar që brenda afatit prej 1 (një) muajve të përpilojë listën e informacionit që do të klasifikohet brenda Shërbimit Korrektues të Kosovës, e cila i dërgohet autoritetit klasifikues.
- Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.


Albulena Haxhiu
Ministër e Drejtësisë



Vendimi iu dërgohet:

- *Anëtarëve të Komisionit;*
- *Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;*
- *Zyrës së Sekretares së Përgjithshme/MD;*
- *Shërbimit Korrektues të Kosovës; dhe*
- *Arkivit të MD-së.*